



Alber Peshkopi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 1833 / Prot. 7

Vlorë më, 21.11.2022

VENDIM  
Nr. 41, datë 21.11.2022

E. Blamaj


PËR  
HAPJEN DHE MIRATIMIN E TARIFËS SË SHKOLLIMIT PËR PROGRAMIN E  
CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE MASTER SHKENCOR NË  
ADMINISTRIM PUBLIK

Në mbështetje të nenit 3, pika 3, gërma ç, nenit 49, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 25, pika 1, gërma i, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë Udhëzimit nr.1, datë 14.04.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, Vendimit nr. 49, datë 14.11.2022 të Senatit Akademik si dhe referuar propozimit të Administratorit ardhur me shkresën nr. 1729/1 prot, datë 14.11.2022, Bordi Administrimit në mbledhjen e datës 21.11.2022,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Biznesit për hapjen e programit të ciklit të dytë të studimeve Master Shkencor në "Administrim Publik".
2. Të miratojë tarifën për programin e ciklit të dytë të studimeve Master Shkencor në "Administrim Publik" si më poshtë:

Emërtimi I programit	Kreditet e programeve te ciklit te dytë te studimeve	Tarifa per kredite ne nje program te pare ciklit te dytë te studimeve	Tarifa e shkollimit per nje program te pare te ciklit te dytë te studimeve	Tarifa per kredite ne nje program te dyte te ciklit te dytë te studimeve	Tarifa per nje program te dytë te ciklit te dytë te studimeve
Program master Shkencor "Administrim Publik"	120	1,100	132,000	1,320	158,400





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
BORDI ADMINISTRIMIT

3. Masa e financimit të plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit do të mbulohet nga Buxheti i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Sotir NIKOLLA**

